

DORACAK PËR ZGJEDHJET



Prishtinë, Maj 2013

Impresum

Titulli: Doracak për zgjedhjet 'Ti je shefi, ti vendos!'

Botuesit:

Albansk Ungdom

JEF Kosova

Civita

Konrad Adenauer Stiftung - Prishtinë

Autorë:

Ardita Osmanaj

Lektorë:

Jeta Jusufi

Koordinimi:

JEF Kosova

Shtypi dhe dizajni:

Printing Press

Grafikat:

Durim Fylli

Tirazhi:

500 ekzemplarë

Publikimi mund të shkarkohet falas në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze në:
<http://www.tivendos.com>

Përmbajtja

Ti je shefi, ti vendos.....	5
Pse është zgjedhur rinia si target grup.....	5
Pse është me rëndësi të votohet.....	6
E drejta për të votuar sipas Kushtetutës dhe Ligjit.....	7
Rëndësia e gjitha etniteteve në zgjedhje.....	8
Gruaja dhe roli i votës.....	9
Regjistrimi i votuesve të rinj.....	10
Shërbimi online në kuadër të projektit.....	11
Votimi i diasporës.....	12
Si të vendosë se kë të votoj?.....	14
Si të sillemi gjatë votimit?.....	16
Partnerët e projektit 'Ti je shefi, Ti vendos.....	17

Vërejtje

Përmbajtja e këtij doracaku shërben vetëm për qëllime informative. Është përdorur çdo mjet i nevojshëm për të siguruar saktësinë e informacionit të shkruar. Informacioni i publikuar në këtë dorack është shkruar në mënyrë që vetë lexuesi të marrë përgjegjësinë për vlerësimin e rëndësisë dhe saktësisë së përmbajtjes së tij.

Ti je shefi, ti vendos!

Ky doracak është rezultat i projektit "Vetëdijesimi i rinisë për sistemin zgjedhor: arsimimi i votuesve të rinj". Ky projekt synon të mbështesë edukimin e votuesve të rinj si parakusht për një demokraci të qëndrueshme. Prandaj, qëllimi i doracakut është të ofroj informacion për të rinjtë si mund të votojnë dhe pse vota e tyre ka rëndësi.

Qeverisja e vendit formësohet nga shumë aktorë duke përfshirë edhe qytetarët. Kjo përfshirje mundëson shpërndarjen e resurseve në mënyrë të drejtë si dhe menaxhim më të mirë. Qytetarët përmes mekanizmave të ndryshëm ushtrjnë presion dhe ofrojnë alternativë ndaj ideve ekzistuese. Mekanizmi më i rëndësishëm është e drejta e votës.

Për të arritur një përfshirje sa më të madhe partnerët e këtij projekti synojnë rritjen e pjesëmarrjes në votime të sa më shumë qytetarëve. Promovimi i politikave dhe projekteve gjithë përfshirëse rritë demokratizimin e shoqërisë.

Doracaku është aktivitet i fazës së parë të projektit tonë, i cili do të përcillet më pas edhe nga aktivitete tjera, si debatet, kampanja televizive, anketime dhe raporte. Aktivitetet e projektit do të realizohen në komuna të ndryshme të Kosovës, ndërsa një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet edhe votuesve të rinj

nga diaspora. Slogani i projektit është 'Ti je shefi, ti vendos'. Arsyja e përdorimit të një slogani të tillë ka ardhur si rezultat i grupeve të interesit në Norvegji dhe në Kosovë, të cilët kanë miratuar këtë ide me sqarimin se të rinjtë përbëjnë shumicën e popullsisë së vendit tonë, ata kanë fuqinë e vendimit dhe janë vetë shef të votës së tyre, prandaj kanë edhe të drejtën të vendosin se kush do të qeverisë.

Pse është zgjedhur rinia si target grup i projektit?

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës grupmosha e rinisë me të drejtë vote është rreth 254 000¹ persona. Sipas KQZsë² rreth 800 000 persona kanë shfrytëzuar të drejtën e votimit. Siç shihet numri i të rinjëve është domethënës dhe kanë potencial në ndikimin e rezultatit të zgjedhjeve. Po ashtu sipas hulumtimeve, tendenca e personave që të votojnë në moshën rinore është shumë e dobishme ngase këtë zell e mbajnë edhe në vitet e mëvonshme³. Element tjetër me rëndësi është futja në politikë të trendeve të fundit siç janë rrjetet sociale. Të rinjtë përmes rrjeteve sociale mund të mobilizojnë votuesit dhe të bashkohen rreth qëllimeve ose koncepteve për jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Të dhënat demografike sipas komunave, 2011, faqe 23. Sipas Agjencisë grupmoshat që hyjnë që rini janë 15 – 27 vjet. Ky raport përjashton moshat 15-17 pasi që ende nuk kanë të drejtë vote..

² <http://www.kqz-ks.org/sq/zgjedhjet-e-pergjithshme>

³ SEI, Young Adults and Electoral Turnout, Dec 2006.

Këto rrjete sociale munden edhe të sensibilizojnë masën e gjerë për idetë politike që përfaqësohen nga politikanët, sa janë të dobishme këto ide, dhe se çfarë në të vërtetë është e dobishme për rininë? Pra, krijimi i opinionëve dhe përcaktimi se çka është në interes të rinisë. Për të përjetuar zhvillime pozitive skena politike, rinia si grup-moshë është shumë e vlefshme dhe kjo është arsyeja kryesore që është target në shumë vende të botës.

Pse është me rëndësi të votohet?

Vota juaj mund të ndikoj në zgjedhjen e personave dhe ideve që mund të avancojnë të ardhmen tonë me arsimim më të mirë, mundësi punësimi, ruajtje dhe manifestim të kulturës, etj.

Zgjedhjet fuqizojnë njeriun që ka talent e virtyt
(Th. Jefferson).

N ë s e n u k
v o t o j m ë
atëherë e gjithë
përzgjedhja e
liderëve bie në

votuesit tradicional të partive politike e që mund të mos kenë synim interesin e përgjithshëm. Pjesëmarrja e sa më shumë votuesve siguron shpërbërje të interesave të ngushta.

Vota jonë nuk është thjeshtë një akt votimi dhe i

zgjedhjes së një kandidati për të qeverisur. Por është më shumë, votimi tregon se kush jemi në shoqëri, çfarë përfaqësojmë, dhe sa dëshirojmë të kemi një të ardhme sipas dëshirës.

SHBA-të kanë rreth 46 milion të rinj nën moshën 30 vjeçare të cilët kanë të drejtën e votes.

Prej tyre rreth 17 milion janë të moshës 18 deri në 21 vjeç.

Kush jemi në shoqëri? Sipas një hulumtimi për rininë dhe votimin në Britani të Madhe⁴, dalja në votime është ndikuar nga pozita e klasës sociale, mobilizimi kognitiv, dhe modelet e nxitjes së votimit. Si te rinjë të githë jemi në gjendje delikate. Ne duhet të vendosim për karrierën tonë, çfarë profesioni të kemi, ku mund të marrim studime kualitative, me profesionin që zgjedhim sa mund të kemi sukses në vitet e ardhshme.

Johan Schumpeter, teoricien i konceptit minimalist të demokracisë, shihte zgjedhjet si mekanizëm për filtrimin e autoritetit. Përmes zgjedhjeve anëtarët e partisë zgjedhin njerëzit më me autoritet. Dhe, njerëzit më me autoritet janë ata të cilët jo doemos duhet të kenë diploma të

⁴ SEI, Young Adults and Electoral Turnout, Dec 2006.

Harvardit por thjeshtë i dëshirojnë të mirën bashkësisë ku jetojnë sepse kanë parime të përvetësuara. Kalimi përmes këtij procesi filtrimi krijon mundësinë më reale të demokracisë së vërtetë. Zgjedhjet fuqizojnë njeriun që ka talent e virtutet (Th. Jefferson). Injorimi i konceptit schumpeterian mundëson që njerëzit me aftësi manipuluese të ngriten në parti dhe pastaj në pushtet. Zgjedhjet të drejta bëjnë që njeriu më i keq të ngritet më së larti (F. Hayek). Mospërfillja e procesit të zgjedhjeve si filtrues nga ana e të rinjëve ka ndikim mbi jetën shoqërore dhe institucionale. Kjo bartet edhe tek institucionet shtetërore ku këta politikanë nuk kanë përvetësuar institucionin e zgjedhjeve si një vlerë por thjeshtë vetëm e njohin atë. Kjo kultivon ndjenjën e të qenurit lider i përjetshëm dhe të përdoren të gjitha mjetet e format për të arritur këtë qëllim.

Gjithë këto elemente ndikojnë që këta liderë të njohin vlerat e demokracisë dhe të shtetit ligjor por jo t'i përvetësojnë ato. Pra, nuk janë pjesë e veprimeve të tyre në politikë. Kjo bën që momentin që marrin pushtetin të mos sundoj ligji por të sundohet ligji. Rrjedhimisht, institucionet injeksohen me autoritarizëm por jo me autoritet ngase ne nuk e kuptojmë rolin tone si 'punëdhënës' të të zgjedhurve. Për të evituar këtë përfundim ne duhet t'i shohim zgjedhjet si filtrim i autoritetit dhe ideve. Ky përfundim krijon mundësi shumë më të mëdha për realizimin e ëndrrave tona.

E drejta per te votuar sipas Kushtetutës dhe Ligjit


VOTIMI SIPAS LIGJIT

Çdo person ka të drejtë për të votuar në zgjedhje në përputhje me ligjin mbi zgjedhjet nëse i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet dhe është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil.

Çdo person me të drejtë vote ka të drejtë të votojë në Kosovë në ditën e zgjedhjeve dhe në zonën zgjedhore ku ai apo ajo është i regjistruar, me kusht që emri i tij apo saj paraqitet në Regjistrin Qendror Civil ose është regjistruar si qytetar i Kosovës në një datë të caktuar nga KQZ-ja.

kriteret e votimit

- a) është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil;
- b) banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës; apo
- c) ka fituar statusin e refugjatit, siç është përkufizuar në Konventën Lidhur me Statusin e Refugjatëve të 28 korrikut 1951 dhe Protokollin e saj të 16 dhjetorit 1966, në apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor i Kosovës;



Kushtetuta dhe e drejta për të zgjedhur (Neni 45 Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes)

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.
2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

Rëndësia e gjitha komuniteteve në zgjedhje

Shoqëria e Kosovës është me kultura dhe etni të shumta. Republika e re u ka dhënë hapësirë të gjitha komuniteteve për pjesëmarrje në qeverisje. Për këtë, Republika jonë është promovuar mbi bazën e konceptit qytetar e në të njëjtën kohë duke i siguruar përfaqësim të gjitha komuniteteve duke përbërë një numër të konsiderueshëm të ulëseve të Kuvendit si dhe poste ministrore.

Duke pasë një numër të madh, llogaridhënia dhe

filtrimit i personave të zgjedhur duhet të shtrihet edhe tek përfaqësuesit e komuniteteve të ndryshme. Avancimi i interesave të komuniteteve duhet të verifikohet dhe sigurohet nga votuesit e këtyre komuniteteve.

Komunitetet (duke përjashtuar atë shqiptar) kanë 20 ulëse të alokuara me qëllim që interesat këtyre komuniteteve të mbrohen dhe avancohen në institucionet më të larta.

Ky përfaqësim ofron edhe mundësi më të mëdha për integrim të të gjitha komuniteteve brenda shoqërisë kosovare.

Ti je shefi, ti vendos, jo vetëm për përfaqësuesit e komunitetit tuaj por edhe të komuniteteve tjera. Ti je shefi, ti vendos.

Gruaja dhe roli i votës

Gratë janë gjysma e shoqërisë. Sipas censurit 2011, në Kosovë banojnë 875,900 meshkuj ndersa 863,925 femra. Modernizimi i shteteve ka shtyrë edhe në avancim të pozitës së gruas. Qysh nga demokracia e Athinës, gratë nuk janë lejuar të votojnë dhe liritë dhe të drejtat politike janë mohuar deri në shekullin e fundit.

Zelanda e Re në vitin 1893 është thënë shpesh të jetë vendi i parë në botë që iu ka dhënë grave të drejtën për të votuar.

Kosova duke qenë një Republikë e re ka krijuar rrafsh ligjor pozitiv me qëllim të nxitjes së pjesëmarrjes së gruas në proceset politike. Sipas ligjit për zgjedhjet, në Kuvend 30% e deputetëve duhet të jenë të gjinisë femërore.

46 shtete në mbarë botën, janë shtete të cilat i japin të drejtën e votës në zgjedhjet locale edhe banorëve të vendit të cilët nuk kanë nënshtetësi të këtyre shteteve.

Megjithatë, si dhe në shumë vende të botës, pozita e gruas në shoqërinë tonë ende mbetet e e kufizuar.

Sigurimi i kuotave të përfaqësimit në Kuvend nuk siguron domosdoshmëri për mirësim të pozitës së gruas. Shembull, mund të kemi përfaqësues/e e cila nuk ka synim avancimin e statusit të gruas. Për të ndryshuar këtë gjendje Ju duhet të Votoni. Ndryshimi i pozicionit në shoqëri mund të arrihet përmes krijimit të politikave të qarta për të drejta dhe mundësi të njëjta

Kuotat zgjedhore për gjinitë përdoren në pothuajse gjysmën e vendeve të botës por, gratë ende përbëjnë vetëm 19% të ulëseve të parlamenteve.

për të dy gjinitë. Votimi i sa më shumë grave do të nxisë sa më shumë kandidatë e politikanë që të përvetësojnë agjendën e përmirësimit të pozitës së gruas.

Gratë që ndryshuan historinë

Sükhbaataryn Yanjmaa nga Mongolia (1953-1954)	Femra e parë ushtruese e detyrës së Presidentit
Sirimavo Bandaranaike nga Shri Lanka (1960-1965)	Femra e parë ushtruese e detyrës së kryeministrit
Isabel Peron nga Argjentina (1974-1976)	Gruaja e parë Presidente
Vigdís Finnbogadóttir nga Islanda (1980-1996)	Gruaja e parë e zgjedhur Presidente dhe gruaja e parë në botë që nuk ka pasur babanë ose burrin liderë shtetëror.
Mary McAleese nga Irlanda (1997-)	Hera e parë që një grua presidente vazhdon drejtpërdrejt nga një grua tjetër presidente

(Huazuar nga Virna Manasieva, trajnere e fushës politike, Maqedoni).

Regjistrimi i votuesve të rinj

Çdo i ri që ka mbushur 18 vjet dhe dëshiron të votojë së pari duhet të regjistrohet.

Autoriteti regjistruar është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i cili ka përgjegjësi të mbaj Listën e Votuesve të azhurnuar. Secili që mbush 18 vjet, në bazë të Regjistrimit Civil, ai futet në listën e Votuesve nga KQZ, por të rinjtë që dëshirojnë të votojnë duhet të vizitojnë Komisionet Komunale të Zgjedhjeve për t'u siguruar për përfshirje në listë. Kështu do të jenë në gjendje të konfirmojnë të drejtën e tyre për votim, përcaktojnë qendrën më të përshtatshme për votim apo ndonjë shërbim tjetër sipas rrethanave.



Zgjedhjet e para me sistemin e votimit online (Electronic voting) janë realizuar në Estoni.

Shërbimi online në kuadër të projektit

Në kuadër të projektit do të jetë aktive edhe web faqja e projektit (www.tivendos.com). Në këtë web faqe do të jenë të postuara të gjitha publikimet tona, informacione për zgjedhjet dhe këndi i blogimit.

Si mund të na ndihmojnë të rinjtë përmes web faqes?

Të rinjtë do ta kenë mundësinë të gjejnë anketa dhe pyetësorë të ndryshëm online, të cilat ne do t'i përdorim gjatë gjithë projektit tonë. Kontributi i tyre mund të jepet përmes përgjigjeve të tyre, të cilat ne do t'i shfrytëzojmë për t'i kompletuar statistikën e votuesve të rinj që do t'i përdorim për raportet tona, e në veçanti për raportin final që do të publikohet.

Gjithsesi një ndihmë e madhe do të jetë edhe ndarja e komenteve, sygjërimeve dhe kritikave me ne, për punën tonë të cilën mund ta monitorojnë online.

Si mund t'i ndihmojmë ne të rinjtë përmes shërbimit online?

Pjesë e web faqes sonë do të jetë edhe këndi i diskutimit (blogimit). Të rinjtë, do ta kenë mundësinë që kërkesat e tyre për ndihmë, shqetësimet e tyre dhe ankesat e tyre të na i drejtojnë në këtë kënd. Përgjigjet në pyetjet dhe diskutimet e tyre do të ofrohen nga zyrtarët e kyqur në project të cilët kanë njohuri për sistemin zgjedhor dhe procedurat e votimit, e gjithashtu do të provojmë që këto kërkesa / ankesa të i delegojmë në forma të raporteve tek zyrtarët kompetentë të KQZ-së.

Në këtë kënd vazhdimisht do të postohen edhe linqe direkte të raporteve të ndryshme dhe institucioneve kompetente të procesit zgjedhor. Gjithsesi edhe të gjithë bashkëbiseduesit do të kenë mundësinë që të përgjigjen në pyetjet e njëri tjetrit, por përgjegjësi për saktësinë e informatave të ndara në këtë kënd do të jepen vetëm për informatat e ndara nga personat kyq të projektit!

Votimi i Diasporës

Votimi i parë nga jashtë u bë në Romën antike si shpikje e perandorit August. Anëtarët e senateve lokale në 28 koloni votuan për kandidatët që synonin zyrat e qytetit të Romës dhe dërguan votën e tyre përmes zarfit të vulosur. Ky lloj votimi ishte rezultat i synimeve politike dhe jo të demokracisë.

Kush mund të votoj?

Të gjithë votuesit me të drejtë vote jashtë Kosovës të cilët në mënyrë të suksesshme kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës mund të votojnë në zgjedhjet parlamentare të Kosovës.

Të drejtë vote kanë, ata të cilët:

- janë të regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil;
- kanë lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t'i plotësoni kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës; apo
- keni fituar statusin e refugjatit, siç është përkufizuar në Konventën Lidhur me Statusin e Refugjatëve të 28 korrikut 1951 dhe Protokollin e saj të 16 dhjetorit 1966, në apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u

regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banori i Kosovës;

- Nëse për zgjedhjet e mëparshme në Kosovë jeni regjistruar si votues për votim jashtë Kosovës dhe keni ofruar dokumente që dëshmojnë të drejtën tuaj për votë.

Si të regjistrohem?

Ju mund të regjistroheni për votim duke dorëzuar:

- Plotësoni formularin për Aplikacion/Regjistrim për votim jashtë Kosovës,
- Ofroni dëshminë e dokumentuar të identitetit dhe që i plotësoni kriteret ligjore për të drejtën për të votuar
- Bashkëngjiten dokumentet e fotokopjuara (shembull: pasaporta e vlefshme, dokument udhëtimi i vlefshëm, patent shoferi e vlefshme, dokument i vlefshëm i ë zhvendosurve, dokument i vlefshëm i Refugjateve etj.)
- I dërgoni me postë në adresën e KQZ-së
- Ky formular dërgohet me postë në KQZ ose përmes faksit te KQZ ja, në numrin e shënuar në fund të Formularit për Regjistrim/Aplikim
- Ky formular duhet të dërgohet në kohën nga 100 deri në 70 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Për më tepër informata dhe kontaktim me personin ndihmës: <http://www.kqz-ks.org/sq/regjistrohu-per-te-votuar>

Nuk e di se si të votoj?!

Pas aplikimit ju pranoni fletëvotimin në adresën që ju e deklaroni. Alternativat janë që pas caktimit të pikave shpërndarëse nga KQZ ju mund t'i merrni personalisht fletë votimet ose t'i shkarkoni nga ueb-faqja zyrtare e KQZ-së.

Pas plotësimit të fletëvotimit votuesi duhet të vendosë fletëvotimin në një zarf të pashënuar e të mbyllur të vendosur brenda zarfit të jashtëm/për dërgim. Në zarfin e dërgimit votuesi gjithashtu vendosë një fotokopje të dokumentit të tij ose saj të vlefshëm të identifikimit dhe një shënim që përmban të dhënat personale të tij ose saj dhe që përmban së paku emrin, mbiemrin, emrin e babait dhe datën e lindjes së tij ose saj.



Pas plotësimit të fletëvotimit për jashtë Kosovës votuesi duhet të dergojë atë në një nga kutitë postare që ngrihen dhe shpallen publikisht nga KQZ deri në datën që përcaktohet nga KQZ.

E nëse kam nevojë për informata shtesë?

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron shërbime informuese për të gjithë qytetarët e interesuar.

Prandaj, ju mund t'i kontaktoni në:

Adresa:

Rr.Migjeni p.nr. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Telefoni:

+381 (0) 38 2111 337

E drejta e votës i takon gjithkujt që është i regjistruar në Regjistrin e Gjendjes Civile. Kjo juve ju bën banorë të përhershëm të Kosovës. Rrjedhimisht, detyrimet e shtetit ndaj juve si dhe detyrimet tuaja ndaj shtetit ende ekzistojnë. Për të krijuar një vend sa më të mirë për të afërmit tuaj, vizitat që realizoni kohë pas kohe, aspiratat për t'u kthyer në një mjedis më të mirë banimi (shembull: mundësi më të mira punësimi), si dhe shërbime më të mira (shembull: pajisje me dokumentacion shpejtë dhe drejtë) ju duhet të votoni.

Kontributi i diasporës ndaj Kosovës gjithnjë ka qenë prezent në formë financiare si dhe kontribut qytetar për zhvillimin e vendit. Përmes votimit ju vazhdoni këtë kontribut duke zgjedhur kandidatë që kanë ide të qarta për zhvillim socio-ekonomik.

Me zhvillimet socio-ekonomike, globalizimit dhe rënies së kufijve sa i përket lëvizjes së njerëzve, gjithnjë e më shumë është e nevojshme rritja e shërbimit për votuesit jashtë vendit. Edhe pse diaspora nuk paguan taksa direkte, si rezultat i lëvizshmërisë gjithnjë e më të madhe, ajo kontribuon përmes dërgimit të parave/remitancave në ekonominë e vendit. Në rrafshin moral, ky kontribut i jep të drejta politike për përfshirje në proceset politike.

- ❖ Për demokracitë si ShBA ky votim filloi të aplikohet pasi që shumë ushtarë ishin në shërbim jashtë vendit.
- ❖ Votimin jashtë vendit e praktikojnë rreth 115 vende në botë

Si të vendosë se kë të votoj?

Zgjedhja se cilët kandidatë duhet t'i votojmë nuk është gjithnjë e lehtë. Prandaj, janë disa teknika që ju ndihmojnë se kënd ta votojmë.

- ✓ **Kupto se cilët janë kandidatët.** Lista e kandidatëve bëhet publike nga ana e partive politike si dhe Komisionit Qendror Zgjedhor. Pas evidencimit, filloni t'i ndëgjoni se çfarë bëjnë dhe thonë për idetë e tyre ndaj problemeve apo çështjeve të ndryshme dhe kjo të ju ndihmojë t'i filtronit se cilët janë më afër vizionit tuaj.

- ✓ **Defino se çka është më e rëndësishme për ty.** Si të rinj ka shumë gjëra që i konsiderojmë të rëndësishme. Por, duhet të zgjedhim se çka ka rëndësi më të madhe. Shembull, nëse planifikoni të studjoni atëherë juve mund të ju interesojnë studime cilësore, investimet në arsimin e lartë, dmth planifikimet e një kandidati apo partije në fushën e studimeve. Mesazhet e kandidatëve i krahasoni me qëllimet tuaja dhe ato që ju duken më të drejta e përafërta ju mundësojnë të përzgjedhni kandidatët potencial.

- ✓ **Kupto të kaluarën politike të kandidatëve.** Kupto se çfarë politika kanë përkrahur në të kaluarën dhe a përputhen me atë që ju e konsideroni të drejtë. Nëse kanë qenë në qeverisje a kanë pasur sukses në realizim të ideve në shërbim të interesit publik.

- ✓ **Lexo gazetat, ndjek debatet.** Në gazeta përveç informative mund të gjeni edhe analiza për candidate dhe çështje të caktuara. Kjo ju ndihmon në formësimin e mendimit tuaj politik. Po ashtu, debatet shërbejnë për ballafaqim të kandidatëve dhe ideve duke ekspozuar pikat e forta dhe të dobëta të secilit kandidat.

- ✓ **Merr pjesë në debatet publike.** Ju mund të pyesni kandidatët për gjërat që ju interesojnë në lidhje me politikën e caktuar.

- ✓ **Krijoni politikanin model.** Vendet e botës kanë pasur politikanë të shumtë që kanë pasur sukses. Lexoni për politikanë që janë shembuj të politikave të mira. Kjo ndihmon në dallimin e cilësive të një politikani të mire.
- ✓ **Dalloni politikanët e pasinqertë.** Jo të gjithë kandidatët thonë të vërtetën apo nuk janë real në premtimet e tyre. Dalloni ata që japin premtime të tepërta apo gënjejnë.
- ✓ **Vendosni për votën tuaj.** Realizoni veprimet e mësipërme dhe kjo ju mundëson të përzgjedhni kandidatët. Kuptoni se cili qëndron më afër ideve tuaja dhe tregon sinqeritet. Ti je shefi, ti vendos.



Si të sillemi gjatë votimit?

Gjatë procesit të votimit, në secilën qendër do të jenë zyrtarët të cilët do të ju udhëzojnë se si të votoni. Gjithashtu në të gjitha vendvotimet, do të jenë monitorues nga shoqëria civile apo partitë politike të cilët do të monitorojnë procesin e votimit.

Sjellja juaj duhet të jetë e kontrolluar, të prisni në radhë, dhe të shmangni manipulimet, të cilat mund të dëmtojnë votën tuaj dhe mund të sjellin pasoja për ju.



Partnerët e projektit 'Ti je shefi, Ti vendos'



Rinia dhe Studentët Shqiptarë në Norvegji (Albansk Ungdom)

Themelimi i Rinisë Shqiptare në Norvegji erdhi si rezultat i një angazhimi të madh shqiptar dhe komunitetit të studentëve. Ky forum është themeluar në vitin 2004 dhe që atëherë ka zgjeruar vazhdimisht rrejtin me anëtarë të rinj, sidomos me anëtarë aktivë nga fusha të ndryshme të studimeve. Si rezultat i këtij zgjerimi është krijuar organizata Rinia Shqiptare në Norvegji (Albansk Ungdom në norvegjisht), e cila është themeluar më 19 prill 2006.

Rinia Shqiptare në Norvegji është një pikë takimi për të rinjtë dhe studentët shqiptarë (të gjithë nën moshën 27). Synimi i punës së organizatës është që të kontribuojë për integrimin e të rinjve shqiptarë në Norvegji, ruajtjen e kulturës, vlerave dhe traditave shqiptare. Gjithashtu një mision i kësaj organizate është edhe motimi i të rinjve shqiptarë që të vazhdojnë me arsim të lartë. Ingjormata tjera rreth organizatës sonë mund të gjeni në: www.albung.no



JEF Kosova

(Federalistët e Rinjës Evropian) është seksion i JEF Evropës me seli në Bruksel, e cila është organizatë supranacionale politike aktive në shumicën e vendeve evropiane, themeluar edhe në Kosovë në vitin 2003. Ajo është organizatë rinore e pavarur nga partitë politike apo nga përkatësitë tjera politike.

JEF Kosova angazhohet për një shoqëri të drejtë dhe demokratike, në të cilën njerëzit nuk janë vetëm absorbues të vendimeve, por edhe pjesëmarrës aktiv në to.

Qëllimet e JEF Kosovës janë të orientuara në promovimin e vlerave evropiane në Kosovë, përsheptimin e integritit të plotë të Kosovës në Bashkimin Evropian, fuqizimin dhe rritjen e të rinjve në politikë, në Kosovë, rajon dhe në arenën ndërkombëtare, promovimin e mirëkuptimit ndërmjet kombeve dhe krijimin e një qytetarie aktive. Të gjitha informatat dhe publikimet tona mund t'i gjeni në: www.jef-ks.org



KAS

Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS) është një fondacion politik nga Gjermania që është angazhuar për nxitjen e demokracisë dhe sundimit të ligjit, për zbatimin e strukturave shoqërore-ekonomike dhe të tregut dhe për të promovuar të drejtat e njeriut. Me rrjetet e saj në mbarë botën ndaj elitave politike dhe sociale dhe me strukturat e saj afatgjata partnere, ajo merr pjesë në formësimin e politikave në zhvillim dhe vendet në zhvillim. Duke trajnuar dhe edukuar profesionistët e rinj, KAS promovon proceset e zhvillimit në grupe shoqërore dhe partitë politike. Fondacioni nxit proceset e decentralizimit të bazuar në vlerat e lirisë, solidaritetit dhe drejtësisë përmes lehtësimit të projekteve për institucionet publike, në mënyrë që të rrisin performancën e tyre teknike dhe administrative.

KAS punon në përputhje me përgjegjësinë e tij krishtere. Statuti i tij përcakton detyrën për të përpunuar bazat për punën politike me anë të hulumtimit dhe konsulencës. Kjo është më shumë se vetëm dhënie e këshillave mbi çështjet aktuale politike. Kjo do të thotë të hulumtosh mbi

implikimet e demokracive të sotme moderne në kohën e mediave e cila përfshin përgatitjen e reformave nga edukimi politik dhe të zhvillohet një politikë ballë kthjellët e cila ndihmon shmangien e krizës paraprakisht. Aktualisht KAS pret më shumë se 200 projekte në rreth 100 vende në katër kontinente me rreth 80 zyra në terren.

Më shumë informata mund të gjenden në: www.kas.de/Kosovo



Civita

Është një OJQ e themeluar kohët e fundit që punon në promovimin e politikave efikase dhe përfaqësuese publike që janë bërë në bazë të interesave të qytetarëve. Civita është e përkushtuar për të pasur një qeverisje të mirë të bazuar në parimet demokratike, institucionet përgjegjëse dhe llogaridhënëse si dhe për vendimmarrje me pjesëmarrje të qytetarëve aktiv. Civita përmes hulumtimeve, avokimit, lobimit, dhe mobilizimit të komunitetit do të ndërmarrin aktivitete që do të rrisin presion publik ndaj proceseve shoqërore, ekonomike dhe politike për të shtyrë përpara alternativa më të mira dhe mundësi për adresimin e mirë dhe zgjidhjen e nevojave të qytetarëve dhe shqetësimet.

Kontakti:

www.tivendos.com

post@tivendos.com

<https://www.facebook.com/TiJeShefiTiVendos?fref=ts>

Përkrahur nga:

